



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT**

---

*Adresa:* Bul. "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Nr. 6 / Pranë ILDKPKI, Tiranë  
*Tel:* 042 220 499 *Fax:* 042 220 466 *Site:* [www.kkk.gov.al](http://www.kkk.gov.al) *E\_mail:* info@kkk.gov.al

**21 Janar 2015**

**Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit**

**Lënda:** Raport i stafit të KKK mbi punën e bërë gjatë vitit 2014

Viti 2014 ka qenë viti i finalizimit të projektit të Bankës Botërore, qëllimi kryesor i të cilit ishte përmirësimi i raportimit financiar të korporatave.

Gjatë gjashtë mujorit të parë vitit 2014, stafi i KKK ka qenë tërësisht i angazhuar në përfundimin e SKK-ve të përmirësuara dhe publikim e tyre. Në korrik të 2014 doli Urdhëri i Ministrisë të Financave për shpalljen e detyrueshme të këtyre standardeve.

Ndërsa në gjashtë mujorin e dytë fokus kanë qenë

- a) plotësimi i pasqyrave financiare me shpjegimet përkatëse të zërave të tyre; dhe
- b) fillimi i projektit të hartimit të SKK për OJF-të.

### **I. Projekti i Bankës Botërore**

Tremujori i parë i vitit 2014 ishte faza përfundimtare e projektit të bankës botërore. Në 30 mars ky projekt përfundoi zyrtarisht dhe u dorëzuan nga konsulenti produktet e mëposhtme:

- a) Memoria e programit TRADOS;
- b) Drafti për diskutim i metodologjisë së hartimit të SKK për OJF;
- c) Matrica e krahasimit të SKK-ve me Direktivën e re të Kontabilitetit të KE;
- d) Forumet ONLINE;

Për realizimin e këtyre produkteve, ashtu si ishte parashikuar dhe në planin fillestar të punës së konsulentit, stafi punoi vetë por u mbikqyr nga konsulenti. Këto produkte të realizuara me sukses janë baza për vazhdimin normal të aktivitetit të stafit të KKK;

- Memoria e TRADOS, aktualisht e mbushur me 15.000 segmente të përkthyer është një premisë shumë e mirë për përkthime konsistente në të ardhmen të përditësimeve të SNK/SNRF të publikuara nga IASB, gjë që u provua në pjesën e mbetur të vitit nga përkthyesit dhe rishikuesit;
- Mbi bazën e propozimit të konsulentit stafi filloi punën për ndërtimin e draftit të SKK-së për OJF. Ky projekt i KKK është aktualisht në proces;
- U përgatit një material rreth 130 faqe ku krahasohen sipas çdo paragrafi SKK-të dhe Direktiva e re e Kontabilitetit në BE. Nga kjo matricë lindën disa propozime të stafit për ndërhyrje në draft SKK-të e përmirësuara si dhe disa propozime për amendime të ligjit për kontabilitetin;
- Forumet Online janë të dy funksionale, forumi për Komitetin e Rishikimit dhe forumi për grupet e punës. Aktualisht është aktiv vetëm forumi i komitetit të rishikimit ndërsa me grupet e punës që ngrihen jashtë KKK me objekt të caktuar vazhdohet të komunikohet në mënyrën tradicionale, telefon ose email.

## **II. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit**

### *1. SKK-të e përmirësuara*

Në pjesën e parë të vitit 2014, stafi u fokusua në komunikimin e SKK-ve të përmirësuara tek publiku i interesuar për të mbledhur prej tij komente dhe sugjerime për ndryshime përfundimtare. Por gjithashtu këtë kohë e shfrytëzoi edhe për të rishikuar variantin përfundimtar të miratuar nga KKK. Absolutisht që pjesa profesionale e SKK-ve ishte kaluar në disa filtra dhe mbledhje të Bordit por rishikimi formal i tyre (gramatika, drejtshkrimi, nr i paragrafëve, titujt përkatës, dispozitat kalimtare, etj) kërkuan kohën e vet.

### *2. Plotësimi i pasqyrave financiare*

Me porosi të Bordit, stafi në tremujorin e tretë të 2014, u angazhua në projektin e plotësimit të pasqyrave të reja financiare sipas modelit të publikuar në variantin e SKK-ve të mëparshme. Pasi stafi ndërtoi draftin e tyre, ua shpërndau këto materialeve grupit të punës të ngritur pranë KKK, me përfaqësues të të gjitha shoqatave profesionale në vendin tonë dhe disa profesionistë të fushës të angazhuar pranë kompanive Big Four. Reagimet ishin zhgënjyese, rasti i vetëm që u përgjigj ishte një përfaqësues i kompanisë Boga &

Law. Pas miratimit të variantit përfundimtar nga Bordi në një nga mbledhjet e fundit të 2014, stafi i publikoi ato në faqen zyrtare të KKK-së.

### 3. *Drafti i SKK për OJF-të*

Në vijim të konsultimeve me konsulentin e Bankës Botërore, në tremujorin e katër të 2014, stafi filloi punën për hartimin e draftit të SKK për OJF. Gjatë këtij tremujori puna e kryer për këtë projekt konsiston në ndërtimin e “skeletit” të standardit. Metodologjia e ndjekur është përshtatja e 14 SKK-ve në atë masë dhe për ato çështje që përbëjnë interes për OJF-të. Ka përfunduar faza e parë e përshtatjes për SKK 1 dhe SKK 2 dhe janë në proces SKK 3 deri SKK 7.

## III. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

### 1. *Përkthimi i SNK / SNRF,*

Gjatë vitit 2014 janë realizuar përkthimet dhe rishikimet e përditësimeve të SNK/SNRF lëshuar nga IASB gjatë vitit 2013. Gjatë këtij viti përkthimi i është ngarkuar vetëm njërit prej përkthyesve të miratuar të KKK, z. Artan Xhiani për faktin se zj. Lamani ka konflikt interesi në ofrimin e këtij shërbimi për sa kohë është Anëtare e KKK. Z. Xhiani ka mundur përkthimin e materialeve si më poshtë:

	<b>Data efektive</b>
1. Ndryshime të SNK 19- Përfitimet e punonjësve	01 korrik 2014
2. SNRF 9 – Kontabilitetit mbrojtës	01 nëntor 2013
3. Përmirësimet vjetore të SNRF 2011-2013	01 korrik 2014
4. Përmirësimet vjetore të SNRF 2010-2012	01 korrik 2014
5. Fjalori i termave – termat e rinj shtesë	

Përkthimet si më sipër pasi janë hedhur në platformën e forumit online të Komitetit të Rishikimit, janë rishikuar nga zj. Rediana Elezi dhe zj. Valbona Kapllani, të dyja në cilësinë e rishikuesve të miratuar nga KKK. Në Komitetin e Rishikimit bën pjesë edhe z. Kledi Kodra por gjatë vitit 2014 nuk ka patur kontribut të tij në procesin e rishikimit.

Pas miratimit nga KKK të përkthimit të materialeve, stafi ndoqi procedurat për t'i dërguar ato për shpallje nga Ministri i Financave. Për burokraci që nuk varen nga stafi i KKK urdhri i Ministrisë nuk ka dalë akoma, ose të paktën në KKK nuk ka mbërritur një shkresë e tillë, siç ka ndodhur me të gjitha praktikantët e mëparshme. Është në proces komunikimi me punonjës të Min Fin për të ndjekur këtë problem.

## *2. Konsolidimi varianti 2013*

Të gjitha materialet e IASB të përkthyer nga Komiteti i Rishikimit të KKK gjatë vitit 2014, janë pjesë e RED BOOK 2013 (varianti i konsoliduar 2013\_IASB). Këto tekste të përkthyer tashmë janë pjesë e memories së programit TRADOS. Duke ndjekur disa procedura në këtë program përkthimi (sipas trajnimit që ka marrë stafi), stafi ka punuar në tremujorin e katërt të 2014 për të mundësuar variantin e konsoliduar 2013, në gjuhën shqipe. Ky projekt është akoma në proces dhe pritet së shpejti t'i jepet Bordit për vlerësim.

## *3. Raportimet mujore pranë IASB*

Për herë të parë, në fillim të viti 2014, IASB kërkoi që çdo anëtar i këtij organizmi rregullator ndërkombëtar të bëjë raportime mujore mbi grafikun e punës së bërë për përditësimin e raportimit financiar ndërkombëtar. Stafi i është përgjigjur kësaj kërkesë shumë korrektësisht dhe në faqen zyrtare të IASB paraqitet progresi që Shqipëria bën në këtë drejtim në mënyrë shumë të përditësuar.

## **DETYRA TË TJERA**

### *a) Organizimi i seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta*

*Tryeza e rrumbullakët "Përmirësimi i SKK-ve"* - Kjo tryezë u organizua nga stafi në qytetin e Vlorës në muajin Maj. Zgjedhja nuk ishte e rastësishme pasi është krijuar një eksperiencë tashmë me tryezat dhe është pranuar përgjithësisht që për pjesën veriore të përzgjidhet Shkodra ndërsa për pjesën jugore të përzgjidhet Vlora dhe Korça. Tryeza e Vlorës pati një pjesëmarrje prej 30 personash, përfaqësues të organizmave profesionalë, auditues dhe kontabilistë të miratuar. Tematika ishte prezantimi i bërë nga stafi për ndryshimet e SKK-ve të përmirësuara dhe u ftuan pjesëmarrësit për komente lidhur me këto ndryshime. Në përgjithësi komentet apo diskutimet fokusoheshin rreth problematikave që këto ndryshime do të sillnin në kushtet kur regjimi fiskal nuk është i harmonizuar me këto ndryshime. Gjithashtu, me interes kanë qenë dhe diskutimet mbi aplikimin në perspektivë të disa prej ndryshimeve që konsiderohen themelore në SKK-të e përmirësuara.

### *b) Organizimi i një takimi dypalësh me homologët kosovarë*

Në fillim të muajit Qershor, në Prishtinë u organizua një takim mes përfaqësuesve të KKK (Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv) dhe përfaqësuesve të KKRF. Takimi kishte në qendër të tij çështjen e përafrimit të raportimit financiar mes dy vendeve. Përveç diskutimit të Kryetarit, edhe stafi kishte përgatitur një material mbi raportimin financiar

të njësive ekonomike të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Ishte parashikuar një diskutim i tillë në axhendën e takimit me kërkesën e palës Kosovare pasi ata janë përballë një vendimmarrje të rëndësishme. Janë në fazën kur janë të interesuar të propozojnë disa amendime mbi ligjin për kontabilitetin dhe janë në diskutime mbi setin e standardeve të aplikueshme. Mbetet opsion zbatimi pa ndryshime i SNRF për NVM, në gjuhën shqipe, përkthyer nga KKK ose mundësia e implementimit të SKK-ve të përmirësuara. Në këtë kontekst u pa me shumë interes një diskutim mbi eksperiencën e KKK në këtë drejtim, pra të qasjes së vendimmarrjes mbi setin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar të NVM-ve.

*c) Mirëmbajtja dhe përditësimi i faqes së internetit*

Stafi i KKK megjithëse nuk ka një person të mirëfilltë për mbajtjen e faqes së internetit (menaxher IT) me mundësitë e veta përditëson rregullisht faqen e internetit duke publikuar aty jo vetëm materiale të SKK, SNK dhe SNRF por të gjitha aktivitetet dhe njoftimet lidhur me punën e KKK. Rezulton që kjo faqe nuk konsultohet gjerësisht nga të interesuarit pasi pjesa më e madhe e komunikimit lidhur me njoftimet për vendime apo aktivitete bëhen në mënyra të tjera si psh, e-mail, telefona, komunikim verbal, etj. Ajo çfarë stafi bën për të promovuar faqen e KKK është që në aktivitetet që zhvillon, në hapje të tyre, si psh seminare apo tryeza të rrumbullakëta prezanton faqen e internetit dhe materialet e publikuara aty.

*d) Komunikimi shkresor me palë të treta*

Një komunikim shkresor shumë i rëndësishëm është ai me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit për çështje të ndryshme. Në komunikimin me Ministrinë e Integritit më shumë fokusi është në raportimet lidhur me progresin në kohë dhe kundrejt detyrave të lëna nga Delegacioni i KE, raport i cili përmbledhet në takimin dyvjeçar të NënKomitetit për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën. Ndërsa lidhjet me Ministrinë e Financave më shumë mbahen nga Nëpunësi zbatues i KKK pasi janë në të shumtën shkresa lidhur me Drejtorinë Buxhetit dhe Drejtorinë e Thesarit.

Në zbatim të VKM 742, datë 07.11.2007, ku KKK ngarkohet me zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi, i cili kërkon zbatimin e SNK/SNRF nga njësitë që plotësojnë dy kriteret e xhiros dhe të të ardhurave, i jemi drejtuar QKR me shkresë për të na mundësuar kontrollin me përzgjedhje të rastësishme të pasqyrave financiare të njësive ekonomike. Me shkresën e parë na u mundësua kontrolli i 28 njësive ekonomike ndërsa shkresat e tjera nuk kanë çuar në përfundime pozitive. Nga QKR nuk ka patur më reagime për kërkesën tonë.

Stafi në mënyrë të vazhdueshme iu përgjigjet të gjitha kërkesave me shkrim të njësive ekonomike lidhur me interpretime të paragrafëve të caktuar apo ngjarjeve të ndryshme të bizneseve të tyre.

Në muajin shtator, është zhvilluar në zyrat e KKK një takim i Kryetarit dhe stafit të KKK me përfaqësues të DPT të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT pas disa

kërkesave me shkrim për bashkëpunim institucional. Në takim u diskutua për mundësinë e firmosjes së një memorandumi bashkëpunimi mes 2 institucioneve. Në kontekstin e bashkëpunimit, në këtë takim, Kryetari u shprehu përfaqësuesve të DPT gadishmërinë e KKK dhe stafit për të ndërmarrë, në interes të kualifikimit të nëpunësve të kontrollit pranë zyrave të tatim taksave, disa iniciativa për ndërtimin dhe organizimin e moduleve të trajnimit për SKK-të e përmirësuara.

Gjithashtu, iu kërkua përfaqësuesve të DPT të vihen në dispozicion të KKK disa informacione mbi njësitë ekonomike, informacione të cilat konsiderohen shumë të rëndësishme lidhur me qëndrimin e KKK për kufijtë e raportimit financiar dhe klasifikimit të njësive ekonomike të vogla dhe të mesme. Takimi nuk u pasua me ndonjë lëvizje konkrete nga DPT përveç faktit që kanë protokolluar në arkivën e tyre një draft të marrëveshjes së bashkëpunimit të draftuar nga stafi i KKK.

Megjithatë stafi vijon të komunikojë me Drejtorinë Juridike të institucionit tjetër për të ndjekur procesin e firmosjes së kësaj marrëveshje.

*Stafi i KKK-së*

*Tiranë 21.01.2015*